


# Garë ndërkombëtare KENGUR 18.03.2021

## Klasa e parë

Koha në disponim është 1h e 15 min.


Për përgjigje jo të saktë të pyetjes minusohet një e katërta e numrit të pikëve me të cilat vlerësohet kjo pyetje. Për të shmangur rezultat të përgjithshëm negativ në fund shtohen 12 pikë, kështu që sasia maksimale e pikëve të fituara është 60. Gjatë punës nuk lejohen kalkulatorët

**Çdo detyrë me numër rendor nga 1 deri 4 vlerësohet me 3 pikë**


1. Kanguri vendos tre shkopinjtë të tillë  që të ndërtojë një formë. Nuk është e lejuar që të thyhen ose të përkulen shkopinjtë. Cilën formë mund ta ndërtojë kanguri?




2. Cila prej rrugëve të treguara në vizatim është më e gjatë?



3. Ela veshi një bluzë dhe qëndroi përpara pasqyrës. Cilën prej këtyre fotove e pa Ela në pasqyrë?





4. Shtatë fëmijë kanë qëndruar në një vijë. Disa janë kthyer përpara ndërsa të tjerët mbrapa. Sa fëmijë mbajnë dorën e fëmijës tjetër me dorën e djathtë?




**Çdo detyrë me numër rendor nga 5 deri 8 vlerësohet me 4 pikë**

5. Goni pret një litar siç është treguar në vizatim. Sa pjesë litarit fitoi Goni në fund të prerjes?



6. Macja Roza ecën përgjatë një muri. Ajo fillon nga pika B dhe i ndjek shigjetat siç është treguar në vizatim. Macja eci 20 metra. Në cilën shkronjë mbaroi ajo?





7. Blerta ka dy kova me lule siç është treguar në vizatim dhe në çdo kovë ka lule aq sa është treguar në vizatim. Ajo duhet të blejë akoma lule dhe t'i vendosë në kovë. Më pas në çdo kovë duhet të ketë numër të njëjtë nga secila lloj luleje. Cili është numri më i vogël luleve që duhet të blejë Blerta?

(A) 2 (B) 4 (C) 6 (D) 8 (E) 10



8. Në vizatimin djathtas janë paraqitur pesë shtëpi të pesë shokëve dhe shkolla e tyre. Shkolla është ndërtesa më e madhe në vizatim. Që të shkojnë në shkollë Drita dhe Arjani kalojnë pranë shtëpisë së Mirit. Era kalon pranë shtëpisë së Anit. Cila është shtëpia e Erës?



**Cdo detyrë me numër rendor nga 9 deri 12 vlerësohet me 5 pikë**

9. Kanguri ka dy degë për drekë. Në secilën degë ka nga 10 gjethe. Kanguri hëngri disa gjethe nga dega e parë. Pastaj, nga dega e dytë hëngri aq gjethe sa i mbetën në degë parë. Sa gjethe gjithsej mbetën në të dyja degët?

(A) 5 (B) 6 (C) 8 (D) 10 (E) 15

10. Letrat e dhëna janë vendosur në dy kuti. Shuma e numrave në çdo kuti është e barabartë. Cili numër duhet të jetë në të njëjtën kuti me 4?



(A) vetëm 3 (B) vetëm 5 (C) vetëm 6 (D) vetëm 5 ose 6 (E) nuk mund të përcaktohet

11. Kanguri Marko ha mollë të hënën, të mërkurën dhe të premten. Të martën dhe të premten ai ha portokallë. Ai ha ose 2 mollë ose 3 portokallë gjatë një dite. Të shtunën dhe të dielën nuk ha asgjë. Sa copë fruta mund të hajë Marko gjatë dy javëve?

(A) 12 (B) 16 (C) 18 (D) 20 (E) 24

12. Dritani ka pesë lodra: top, grup kubikësh, kamion, letra zbavitëse dhe makinë. Ai e vendos çdo lodër në raft të ndryshëm të dollapit të tij. Topi ndodhet më lart se kubikët dhe më poshtë se makina. Kamioni është menjëherë mbi topin. Në cilin raft mund të vendosen letrat zbavitëse?

(A) 1 (B) 2 (C) 3 (D) 4 (E) 5

